



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.71 prot.

Himarë, më 27.11.2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA
ORGJINALI, I MBAJTUR NË MBLEDHJEN E RADHËS PËR MUAJIN NËNTOR
,MË DATËS 27.11.2024.**

Sot më datë 27.11.2024, ora 10:30 zhvillohet mbledhja e radhës të këshillit Bashkiak Himarë.
Mbledhje e hapur.

Të pranishëm : kryetari Bashkisë, drejtoritë, kryetarët e fshatrave, administratorët e njësive
Himarë.

Marrin pjesë këshilltarët: 1. Aleks Llazari, 2. Timoleo Gërdhuqi, 3. Dhimitër Kapaj, 4. Elisabeta
Lamaj, 5. Milto Nika, 6. Gjergji Iliadhi, 7. Thodhori Foto, 8. Artionil Shirokaj, 9. Lenica
Kocani, 10. Loreta Isufi, 11. Nertila Husi, 12. Afrovita Dhimojani, 13. Silva Burbo, 14.
Miltiadh Prifti, 15. Qirjako Mërkuri, 16. Mirka Gjçali, 17. Nikolin Laska.

Mungojnë : 1. Artan Bala, 2. Maks Vlasi, 3. Fuat Mati, 4. Thëllëza Kokaveshi (me arsye)

Plotësohet Kuorumi këshilltarëve mbi 50%

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z. Dhimitër Kapaj

Përsëndetje! Fillojmë mbledhjen me rendin e ditës.

Jeni dakort me rendin e ditës? PO, Këshilli.

Pika 1.

Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesa të qytetarëve.

Kryetari këshillit lexon kërkesën e ardhë nga këshilli zonal OVP e njësisë Horë – Vranisht i
cili kërkon të miratohen në këshill 5 emra me influencë për qytetar nderi të Bashkisë Himarë .

Këshilltari Artionil Shirokaj: - Unë e kam lexuar dhe jam dakort për mjekun e Tërbaçit Z.
Pajtim Skëndaj, pas daljes në pension ka dhënë kontributin e tij human në tërë zonën, edhe
për personat e tjerë që janë në listë përderisa vijnë si propozime mendoj se e meritojnë.

Këshilltari Qirjako Mërkuri :- TË bëhet kujdes sepse emrin qytetar nderi nuk mund ta
marrë gjithkush, është një titull me nder dhe vlerë.

Këshilltarja Elisabeta Lamaj :- Unë jam dakort t'i miratojnë sepse i njohë dhe di
jetëshkrimi e tyre, kanë kontribuar edhe në luftën nacional çlirimtare.

Sqaron sekretari këshillit :- kemi një ngërç të cilën duhet ta zgjidhëm si këshill. Në komisionet e përhershëm duhet të shtojmë një komision për tituj nderi vendor pasi ligji kështu e kërkon ,të ngremë komisionin e miratojmë në këshill dhe pastaj shqyrtojmë kërkesën.

Kryetari këshillit:- ngrem komisionin , jeni dakort

Hidhen në propozim tre anëtarë këshilli për komisionin qytetar nderi ,Artionil Shirokaj , Milto Nika, Thëllëza Kokaveshi.

Kryetari këshillit kërkon informacion më të detajuar nga juristi Bashkisë.Të jepen tituj vendor i takon këshillit bashkiak, 3 anëtar apo sa të doni ju duhen nga këshilli dhe dy të jenë nga jashtë këshillit njerëz me influencë e të përfshirë në aktivitete kulturore më tepër dhe më vonë ngarkohet administrata.

Pika 2

Raport nga drejtoria e policisë bashkiake.

Jep raport drejtori mbi gjendjen dhe masat e marra në sigurinë dhe ruajtjen e territorit të bashkisë.

Këshilltari Gjergji Iliadhi:- Çfarë zgjidhje keni patur për shezllinët? Kemi marrë masa ,problem ka qënë çuarja e shezllonëve në plazhet publike.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- A ka një raport për ndërtimet e paligjshme?

Drejtori – kjo nuk është kompetencë e jona.

Këshilltari Milto Nika:-juve e kufizoni punën tuaj vetëm te problemet e plazheve keni forcë dhe kompetenca më tepër dhe duhet të procedoni sipas ligjit, zhurmat ,muzika e lart e diskove në qëndër,papastërti e shumë të tjera në kohën e turizmit.

Këshilltarja Silva Burbo:- Ne kemi kaluar në strukturë numrin e policisë bashkiake dhe dua të fitoj a ‘ është i mjaftueshëm dhe a’ ka patur probleme , konflikte dhe dua të di si keni proceduar me zhurmat?

Drejtori:- numri punonjësve është i mjaftueshëm ndërsa me zhurmat kemi patur dy raste dhe i kemi normalizuar

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- me policinë e rendit keni bashkëpunim? Po:- Drejtori.

Po brenda strukturës është kontrolli i qarkullimit rrugor dhe nëse jo ,do të ngrihet brenda policisë bashkiake?

Kryetari bashkisë:- vitin që vjen do ta realizojmë dhe do ta sjellim ta miratoni ju , do të zbatohet sistemi gjobave për parkim të parregullt ,do të kemi një marrëveshje me policinë e shtetit.

Këshilltarja Elisabeta Lamaj:- policia e shteti duhet të pajiset me uniformë. **Kryetari Bashkisë:-** shumë e drejt kjo,vitin që vjen do të pajisen.

Kryetari fshatit Gjilekë kërkon leje:- kemi problem zbatimin e plazheve publike, xhurmat,çertifikatat e pronave ,dëmtimi i ullinjve, shërbimi i ujit, shërbimi pastrimit, kemi problem në sezonin e ullirit vjedhjen dhe prerjen e tyre,kërkoj për këtë ndihmë nga bashkia.

Kryetari këshillit :- duhet të bësh kërkesë në bashki? A'ke bërë për dëmtim të ullinjve?

Këshilltari Qirjako Mërkuri :- zotëria ka të drejtë për ullinjte,duhet të merren masa në mbrojtjen e tyre. Mbështet parafolësit këshilltari Nikolinë Laska.

Këshilltarja Silva Burbo :- policia Bashkiake duhet të funksionojë në bazë të rregullores dhe të jetë në mbrojtje të qytetarëve dhe nëse kanë mangësi në rregullore le të përpilohet dhe të sillet në këshill për miratim.

Këshilltarja Mirka Gjiçali:- unë me doj në çdo fshat të caktohet nga një roje dhe të paguhet nga bashkia.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- Kryesitë e fshatrave duhet të procedojnë në bazë të rregullores dhe duhet t`u drejtohen drejtorive me kërkesë ,juve zotri keni çuar kërkesë? Nëse nuk keni marrë zgjidhje nga administrata atëherë duhet të na drejtoheni ne si këshill.

Pika 3

Raport për ecurinë e planit të përgjithshëm vendor Himarë.

Këshilltarja Silva Burbo :- A ka shkelje mbi këtë plan dhe jeni duke i rishishikuar të gjitha kërkesat ? Jemi duke punuar dhe padyshim që çdo kërkesë e ardhur do të shqyrtohet .

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- ne si këshill në vitin 2023 kemi marrë vendim për zgjerimin e vijës së verdhë,sa kërkesa ka?

Drejtori Klodi Ajazi :- kërkesat më të shumta i kemi nga familjarët dhe jemi duke i shqyrtuar një për një.

Sqaron kryetari Bashkisë :- Komisioni i ngritur donte ta mbyllte punën një muaj më parë ,unë u kërkoja të shtyhej të zgjerohej më shumë vija e verdhë që të kishte mundësi çdo qytetar të aplikonte sepse zhvillimi i Himarës e kërkon një gjë të tillë.

Këshilltari Aleks Llazari:-më shumë ndërtohen resorte. Lejet për resorte nuk i ka dhënë bashkia :- Kryetari.

Këshilltarja Afrivita Dhimojani : problemi është te çertifikimi tokave të cilat nuk i kemi .

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:-ky është një raportim deri ku ka shkuar plani dhe kjo nismë duhet të transmetohet te banorët nga kryetarët.

Kryetari këshillit :- ne do të bëjmë një dëgjese publike për këtë çështje .

Qytetar nga Dhërmiu:-kemi bërë takim me ministren Klodita për çështjen e territorit ,tokave të vjedhura ku i kanë zaptuar të tjerë , kërkojmë regjistrimin e pronave ,është spostuar vija e verdhë ,vija bregdetare.

Këshilltari Miltiadh Prifti :- Herë e dytë që na vjen si informacion dhe nuk kemi informacion se kush janë dhe a' aplikojnë të gjithë pronarët, si procedohet.Jemi duke punuar për tu dhënë mundësinë çdokujt për të aplikuar.

Pika 4

Shqyrtimi paketës fiskale

Kryetari këshillit kërkon nga Kryetari komisionit të lexojë raportin . Kryetari komisionit Gjergji Iliadhi :- Si komision gjatë shqyrtimit kemi dal në disa pika për t'i shqyrtuar në këshill.

Pika 1. Taksa e ndërtesës të aplikohet nga Sh.A.Vlorë, Taksa e truallit për familjarët të mos ndryshoj, taksë e ndikimit në infrastrukturë të shkojë 0.5% në zonën B pra zona rurale të mos ketë rritje takse , taksa e truallit 8% ,taksa për ndërtimet hoteleri në 5% , jo për familjarët , Bujqësia dhe blektoria të mos ketë rritje takse , zero ,tarifa e pastrimit të paguajnë në bazë të sasisë nga 20% në 10 % ,Blegtorale t'u ulet tarifa dhe kontratat t'u jepen 5 vjeçare (propozim nga Kryetari këshillit)

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi: të diskutojmë tarifën për bizneset dhe të na sqaroi drejtori financës.

Drejtori Laert Mezani :- nën zero përqind nuk na e lejon ligji

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- unë mendoj objektet me qëllim turistik nga 4% e çojmë në 5% tarifën ,zonat B nuk janë prekur nga rritja e taksës.

Këshilltari Qirjako Mërkuri :- mbi ç' bazë vendoset tarifa e pastrimit ? Sqaron drejtori :- ngrihet një komision nga bashkia dhe veprojmë sipas VKM , ndotësit më të mëdhenjë janë hotelerit ,bizneset ,resortet...

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- taksën e pastrimit nuk mundemi ta ulëm sepse vetëm te tarifa mundemi.

Kryetari këshillit jep 10 min pushim dhe pastaj rikthehemi në mbledhje.

Mbas pushimit vazhdojmë mbledhjen.

Kryetari këshillit :- diskutojmë tarifën e pastrimit për bizneset ,kush ka pyetje,propozime?

Këshilltarja Silva Burbo :- ka biznese që vetëm gjatë sezonit kanë punë ndaj nuk jam dakort për rritje.

Kryetari këshillit të dalin me vendime secili grup dhe pastaj i hedhim në votim ndryshimet.

Komisioni shprehet se tarifa pastrimit për bizneset , turizmin është 20% për tre vjet

Hidhet në votë për 15% tarifa pastrimit për bizneset e kategorisë B, zonat rurale ,miratohet.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- propozon për zonën kategoria A të shkojë tarifa në 50% për bizneset (diskutojnë këshilltarët)

Mbledhja e tarifës për ShA. Vlorë për pastrimin komisioni këshillit diskutojë që kjo tarifë t'i shkonte OSHE ose zyrës së taksë tarifës:- **shprehet këshilltarja Silva Burbo. Sqaron kryetari Bashkisë:-**ne kemi një konflikt me ujësjellësin dhe diskutova me OSHE për këtë çështje dhe ngelet t'i mbledh taksat ujësjelësi ose bashkia, që ta bëj bashkia është e vështirë

sepse na duhen agjent tatimore , menduam nga 5% tarifa e Sh.A. ta ulim në 2% dhe t'ja kalojmë ujësjellësit .

Këshilltarët Silva dhe Afrovita : ne nuk e kemi miratuar këtë marrëveshje kryetar .

Kryetari : - problemi është mbledhja e tarifës ,e vendosni ju si të operojmë .

Sqaron përgjegjës departamenti financës Donald Bello :- Në 2017 është lidh kjo marrëveshje me Sh.A. Vlorë dhe qytetari është i kënaqur.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- Flitet për shoqërinë Sh.A.Vlorë dhe si këshill nuk e kemi miratuar madje në mbledhjen muaj prill që bëmë në Tërbaç të gjithë si këshilltarë kemi dal në tre vendime për t' u zgjidhur kjo marrëveshje ,i jemi drejtuar KLSH , gjykatës ,Bashkisë. **Sqaron kryetari bashkisë:-** Personalisht të më pyesnin kam qënë kundra dhe jam duke lobuar për të zgjidhur por kjo pikë duhet të zgjidhet.

E hedhim bë votim si pikë :- kryetari këshillit.

Hidhet në votim , 11 këshilltarë janë pro me 2% ti mbledh ujësjellësi.Këshilltari Timoleo është kundra me këtë pikë dhe pjesa tjetër e opozitës është kundër .

Kryetari këshillit :- e hedhim në votim të gjithë paketën fiskale?

Hidhet në votim

Miratohet paketa fiskale me 17 vota pro , zero kundër , zero abstenim

Miratohet vendimi nr.34 mbi ndryshimet në paketën fiskale .

Shtesë për paketën fiskale (Afrovita ,plazhet publike rë ngelen publike) Kryetari këshillit :- Komisioni ka vendosur për një vit projekt pilot në dy plazhe Borsh dhe Dhërmi.

Pika 5

Për miratimin e projektit dhe udhëzuesit “ të rinjë dhe të reja drejt një profesioni ”

Pyetje – diskutimi në këshill. **Pyetje nga Kryetari komisionit:-** duam të dimë sa vend zë në buxhet. Sqaron drejtorja përkatëse : do të vi me buxhetin juve do ta miratoni.

Kryetari këshillit:- e kalojmë në parim?

Miratohet vendimi nr.35 “ Për të rinj dhe të reja drejt një profesioni”

Pika 6

Tërhiqet projektvendimi për korrigjimin e gabimit në në shkrim të vendimit të KBH nr 33 datë 27.05.2022

Pika 7

Miratohet vendimi nr.36 për dhënie burse të nxënësit Arjol Gentjan Hoxhaj (17 vota) pro

Miratohet vendimi nr.37 për dhënie burse të nxënësit Eriselda Ernest Guxhaj (17 vota) pro

Pika 8

Miratohet vendimi nr.38 mbi dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 30 tetor nga fondi I kushtëzuar 6% I bllok – ndihmës ekonomike.

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen dhe ndërkohë këshilltarët firmosën protokollin e mbledhjes.

Sekretari

Elena Memushaj



Kryetari

Dhimitër Kapaj

